



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 122/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.03.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** “Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur” me me Nr. REF-66497-02-02-2017, me objekt: “Prodhimi i formularëve dhe kartave të shëndetit”, me fond limit 21.553.902,58 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.02.2017 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.”

**Ankimues:** “Albdesign PSP” sh.p.k  
Rruga “Çerçiz Topulli”, Nr. 17, Kashar, Tiranë

**Autoriteti kontraktor:** Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor,  
Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 8,  
Tiranë

**Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.02.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me me Nr. REF-66497-02-02-2017, me objekt: “*Prodhimi i formularëve dhe kartave të shëndetit*”, me fond limit 21.553.902,58 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.02.2017 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.

II.2. Në datën 08.02.2017 operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë ngrihen pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit të mësipërm. Konkretisht pretendohet si vijon:

*Bazuar ne nenin 63 te LPP, po ju dergojme per shqyrtim formularin standard te ankimit, lidhur me proceduren e mesiperme te prokurimit, duke qene se nga ana e njesise se prokurimit te institucionit qe ju drejtoni, jane hartuar kriteret per kualifikim diskriminuese dhe ne kundërshtim me ligjin.*

- 1. Ne kriteret per kualifikim keni kerkuar xhiron mesatare per tre vitet e e fundit, konkretisht per vitet 2014, 2015 dhe 2016 vite keto te cilat nuk perputhen me periudhen kohore per bilancet e tre viteve te fundit. Pra, lidhur me keto kriteret*

- per kualifikimn, ku ne te dy rastet keni percaktuar fjaline per tre vitet e fundit, duhet edhe te saktsoni se kush jane tre vitet e fundit, pasi nuk perputhen midis tyre.
2. Gjithashtu keni percaktuar qe, bilancet duhet te jene pozitive per vitet e kerkuara, nderkohe qe dispozita e mesiperme nenligjore, nuk e parashikon nje kerkese te tille.
  3. Kerkesa juaj qe, duhet te paraqitet vertetimi i xhiros per persona fizike, nderkohe qe per personat juridike kerkohen bilancet e tre viteve te fundit, eshte nje kerkese absurde, e cila nuk gjen mbeshtetje ligjore. Gjithashtu, nje percaktim i tille, nuk i ve ofertuesit ne kushte te barabarta konkurimi.
  4. Ne kundersiztim te plote me legjislacionin e prokurimit publik, keni kerkuar qe vertetirni i leshuar nga OSHEE, duhet te jete leshuar jo me pare se 10 dite nga hapja e ofertave, kerkese kjo e cila nuk gjen mbeshtetje ligjore, si dhe bie ne kundersiztim te plote me dokumentat standarde te tenderit. Kjo per faktin se, autoriteti juaj kontraktor nuk mund te detyroje operatorin ekonomik se kur duhet te shlyeje detyrimet e energjise per te marre vertetimin perkates. Pra e rendesishme per ju eshte qe shoqeria te mos kete detyrime te energjise elektrike, si dhe nuk ka asnje rendesi se cfare date mban ky vertetim.
  5. Ne kundersiztim te plote me legjislacionin e prokurimit publik, njesia juaj e prokurimit ka kerkuar sherbime te se njejtes natyre, nderkohe qe legjislacioni i prokurimit publik, parashikon per sherbime te ngjashme. Kerkesa juaj qe duhet te jene te se njejtes natyre sjell per pasoje kualifikimin e shoqerive qe kane vetem sherbime te njejta pra identike me objektin tuaj, nderkohe qe ligji e ndalon nje kerkese te tille, pasi ka te parashikuar shume qarte, per sherbirne te ngjashme.
  6. Gjithashtu, kerkesa juaj qe, sherbimet identike, pra te njejta, duhet te jene realizuar ne vitet 2014, 2015 dhe 2016 bie ne kundersiztim me legjislacionin e prokurimit publik, i cili parashikon tekstualisht per tre vitet e fundit.

Per analogji, nje kontrate e perfunduar ne muajin janar 2014, nuk mund te quhet e realizuar brenda tre viteve te fundit, pavaresisht kerkeses tuaj antiligjore qe e perfshin kete vit, si dhe nuk mundet dot qe, nje kontrate e perfunduar ne janar 2017 te quhet jashte tre viteve te fundit, pasi ju vete kete percaktim keni bere.

Atehere, lind pyetja, perse nje kontrate apo funizim i perfunduar ne muajin janar 2017, perse nuk njihet nga institucioni juaj?

Gjithashtu, ne kundersiztim te plote me LPP, njesia juaj e prokurimit ka kerkuar qe, kur kontrata eshte realizuar me institucione shteterore, te paraqitet kontrata, shoqeruar me vertetimin perkates. Nderkohe, LPP per kete rast, parashikon paraqitjen ne tender te vertetimit te leshuar nga nje ent publike dhe/ose faturen tatimore te shitjes.

7. Ne kriteret specifike per kualifikim, keni kerkuar qe shoqeria duhet te kete te punesuar 20 punonjes.

Lidhur me kete kriter diskriminues, se pari sqarojme se, objekti juaj i prokurimit, mund te realizohet edhe me vetem 10 punonjes dhe brenda nje afati 12 dite pune. Argumentuar kjo si vijon per numrin e punonjesve dhe afatin e realizimit te ketij produkti:

I. Procesi i shtypit kerkon 1 makinist dhe 1 ndihmes makinist dhe realizohet ne 4 dite pune.

II. Procesi i plastifikimit fillon ditën e dytë të punës dhe kërkon si afat maksimal prej 3 ditësh të tilla pune dhe 1 punonjës

III. Procesi i Numratorit automatik kërkon po 3 ditësh pune dhe 1 punonjës

IV. Procesi i Prerjes kërkon vetëm 2 ditësh pune dhe 1 punonjës

• Gjithashtu do duhen edhe punonjësit si vijon për realizimin e këtij procesi:

I. 1 financiar, 1 magazinier, 1 projekt menaxher dhe 1 dizajnues (grafik designer).

Pra subjekti mjafton të ketë të punësuar maksimalisht 10 punonjës jo më tepër, atëherë pse në kriteret kërkohej një mesatare prej 20 punonjësish për më tepër në 3 vite.

Se dyti, numri i punonjësve të kërkuar, është i tejfryrë, si dhe nuk është në raport me vëllimin e kontratës dhe makineritë/pajisjet e kërkuara në dokumentat e tenderit.

Se treti, njesia juaj e prokurimit nuk ka përcaktuar saktë lidhur me numrin e punonjësve, ku duhet të parashikojë numrin mesatar të tyre.

Se katërti kërkesa edhe për vitin 2014 është diskriminuese, në kundërshtim me ligjin, si dhe ul konkurrencën në prokurim. Kjo për faktin se, numri i punonjësve për muajin janar 2014 është jashtë tre viteve të fundit.

Pra, e rëndësishme për institucionin tuaj është që operatori ekonomik të disponojë numrin e punonjësve, për të paktën tre muajt e fundit, si dhe nuk ka asnjë rëndësi për ju nëse i ka patur apo jo këtë numër edhe për vitet 2014 dhe 2015. Një kërkesë e tillë, sjell si pasojë uljen e konkurrencës në prokurim, si dhe diskriminimin e kandidatëve.

Argumentimi i dhënë në kërkesat për kualifikim ku keni parashikuar për arsye të afatit të limituar për realizimin e prodhimit të formulave dhe kartave të shëndetit, është një arsyetim dhe argumentim antiligjor, i cili nuk ka të bëjë me kërkesat për kualifikim, si dhe nuk gjen mbështetje ligjore. Ju kujtojmë se, procedurën e prokurimit ju mund ta kishit zhvilluar edhe më parë, deri në fazën e nënshkrimit të kontratës, pra afati i limituar është shkaktuar për shkak të neglizhencës së njesisë tuaj të prokurimit.

Pra, kjo kontratë realizohet edhe me vetëm 10 punonjës, pavarësisht kërkesave dhe sqarimeve tuaja antiligjore.

Arsyetimi dhe argumentimi se, ky numër duhet sipas kërkesave të AK, të përcaktuar në kontratë, pjesë e kërkesave për kualifikim, është diskriminuese, si dhe sjell si pasojë paragjykimin e procedurës së prokurimit.

Autoriteti juaj kontraktor duhet të specifikojë këto kërkesa në specifikimet teknike, pasi, ashtu sikurse edhe ju i dini, kontrata nënshkruhet pasi të ketë përfunduar procedura e prokurimit, si dhe nuk kanë mundësi kurrsesi shoqëritë të dinë se çfarë do të parashikohet në kontratë nga ana e institucionit tuaj dhe shoqërisë fituese.

Pra, ky informacion duhet të bëhet publik për të gjitha shoqëritë, kjo me qëllim për të vënë ofertuesit në kushte të barabarta konkurrimi, si dhe për të zhvilluar një garë publike [...].

II.3. Në datën 15.02.2017, autoriteti kontraktor ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit dhe ka publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve shtojcën me ndryshimet e dokumentantave të tenderit si vijon:

“1.Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4  
Ishte

*-Një vërtetim nga furnizuesi i energjisë elektrike, që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, lëshuar jo më parë se 10 ditë nga data e hapjes së ofertave.*

*Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3 kapaciteti teknik ,pika 1, gërma a) gërma b)*

*Ishte*

*- Furnizime të mëparshme të së njëjtës natyrë në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se 8,621,561.03 lekë), furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2014, 2015, 2016) të aktivitetit të operatorit ekonomik.*

*Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- a. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është e realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate .*

*OSE*

- b. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturën/at përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.*

*Bëhet*

*1.Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4*

*Një vërtetim nga furnizuesi i energjisë elektrike, që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

*2.Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3 kapaciteti teknik pika 1, gërma a) gërma b)*

*Furnizime të mëparshme të ngjashme në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se 8,621,561.03 lekë), furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2014, 2015, 2016) të aktivitetit të operatorit ekonomik.*

*Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- a. Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me institucionet shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur vërtetimet e lëshuara nga institucionet shtetërore dhe faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat ,shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*OSE*

- b. Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturën/at përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.*

*II-Ndryshimi i datës së hapjes të ofertave*

*Data e hapjes së ofertave ishte në datë 27.02.2017 ora 11<sup>00</sup>  
Data e hapjes së ofertave bëhet në datë 06.03.2017 ora 11<sup>00</sup>.*

II.4. Në datën 20.02.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.5. Në datën 27.02.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 251/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 873/2 prot., datë 24.02.2017 me objekt: *“Informacion i detajuar lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Prodhim i formularëve dhe kartave të shëndetit”*”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi trajtimin e ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *“Ne kriteret për kualifikim është kerkuar xhiro mesatare për tre vitet e fundit, konkretisht për vitet 2014, 2015 dhe 2016 vite keto të cilat nuk përputhen me periudhën kohore për bilancet e tre viteve të fundit. Pra, lidhur me keto kritere për kualifikim, ku në të dy rastet është percaktuar për tre vitet e fundit, duhet edhe të saktësohet se kush janë tre vitet e fundit, pasi nuk përputhen midis tyre”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti ekonomik e financiar”*, pika 2, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar paraqitja e dokumentacionit si vijon:

*“Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron mesatare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (viti 2014, 2015, 2016), kjo mesatare nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e fondit limit prej 21,553,902.58 (njëzetënjë milion e pesëqindpesëdhjetëetremijë e nëntëqindëdy pikë pesëdhjetëetëtetë) lekë.”*

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “c” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*;

*c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e*

ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;”

III.1.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 4, gërma “a” dhe “b”, thuhet se:

*“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose*

*b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet;*

*Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.”*

Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Legjislacioni tatimor nuk parashikon afat për deklarimin e xhiros vjetore, rrjedhimisht në cdo moment subjektet mund të kërkojnë pranë administratës tatimore vërtetim për xhiron vjetore të realizuar deri në momentin e paraqitjes së kërkesës. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se ndryshe nga pasqyrat financiare të cilat në bazë të legjislacionit tatimor kanë afat deklarimi deri në fund të marsit të vitit pasardhës, ky afat nuk aplikohet për xhiron vjetore. Në këto kushte periudha 2014, 2015, 2016 e përcaktuar nga autoriteti kontraktor është në përputhje me frymën e ligjit dhe mund të plotësohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë, bazuar në vërtetimet që lëshohen nga administrata tatimore.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa i përket pretendimit se periudha e kërkuar për xhiron nuk përputhet me periudhen kohore për bilancet e tre viteve të fundit, rezulton se në kriteret e vecanta të kualifikimit janë kërkuar bilancet e viteve 2013, 2014 dhe 2015, në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku në nenin 29, pika 1 thuhet se:

*“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji...”.*

Në kushtet kur bilanci kontabël përgatitet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës si dhe duke qënë se procedura e prokurimit është parashikuar për tu zhvilluar në muajin mars

2017, kërkesa e autoritetit kontraktor për bilancet e viteve 2013, 2014 dhe 2015 është hatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi si më sipër cituar.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit: *“përcaktimi që bilancet duhet të jenë pozitive për vitet e kerkuara, nderkohe që dispozita e mesiperme nenligjore, nuk e parashikon një kerkese të tillë”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti ekonomik e financiar”*, pika 3, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar paraqitja e dokumentacionit si vijon:

*“Kopje të 3 (tre) bilanceve në tre vitet e fundit (viti 2013, 2014, 2015 ) të pranuar nga Administrata Tatimore me rezultat pozitiv për personat juridik, ose kopje të deklaratimit të xhiros vjetore në Administratën Tatimore për personat fizik.”*

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 gëmra “c” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se : *“ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*  
c) *gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;*

III.2.3. Në nenin 28 *“Kontratat e Shërbimve”* pika 4, gërma “a” të Vendimit Nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

*“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) *kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse*

...

*Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës“*

III.2.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.2.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumnit të saj autoriteti



kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, si edhe specififikimet teknike duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në interpretimin teleologjik të nenit 46 pika 1 gërma “c” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, KPP gjykon qëllimi i normës së mësipërme juridike lidhet me vënien në dispozicion të autoriteteve kontraktore të mekanizmave ligjor mbi vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit me anë të cilave të vërtetohet se operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën. *Strictu sensu* ligjëvënësi ka parashikuar edhe mjetet ligjore (dokumentacionin ospisonal) që mund të dorëzohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e synimit të normës juridike dhe njëherazi të qëllimit të autoritetit kontraktor si me anë të: deklaratave bankare ose, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. KPP gjykon se kuadri ligjor në asnjë rast nuk parashikon se dorëzimi i bilancit të më shumë se një viti negativ (me humbje) tregon pa aftësinë financiare për përmbushjen me sukses të kontratës. Akoma më tej, vetë kuadri ligjor në fushën e procedurave tatimore, *lex specialis* ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nuk penalizon në asnjë rast subjektet juridikë në ushtrimin e aktivitetit të tyre tregëtar edhe në rast se bilanci i një ose më shumë viteve rezulton me humbje ( negativ). I vetmi penalizim parashikohet në ligjin nr.8901 datë 23.05.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, në të cilin referuar nenit 14 pika 1 parashikohet se *procedura e falimentit hapet me kërkesë të organeve tatimore kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë tre vjeçare*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të drejtë kërkesën e autoriteteve kontraktore mbi dorëzimin e bilancave financiare për tre vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit tregëtar ushtrimor, si një e drejtë e cila rrjedh nga *lex specialis* dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Nga ana tjetër, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme lidhet *strictu sensu* me njohjen e aftësisë së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për të marrë pjesë në qarkullim civil si subjekt tregëtar si edhe duke shfaqur aftësi paguese ndaj të tretëve dhe ndaj shtetit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dëshmia se bilanci financiar i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi ka rezultuar me humbje për një ose disa vite nuk është një parakusht *sine qua non* që tregon pa afatësinë paguese të tij dhe njëherazi rrezikun potencial të mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ndër parimet kryesore të përgatitjes së pasqyrave financiare, referuar Standardit Kombëtar të Kontabilitetit ( SK) është ai *vijimësisë*. *Parimi i vijimësisë* do të thotë se veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijimësi dhe njësia ekonomike nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj. Sa më sipër, KPP gjykon se një operator ekonomik nuk mund të skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit *ipso facto* se ka dëshmuar se një ndër pasqyrat financiare të aktivitetit financiar të këtij të fundit ka rezultuar me humbje, kur në asnjë rast nuk ka dëshmuar se ndodhet në kushtet e humbjeve në vijimësi (referuar parimit të SK), apo në gjendjen e insolvabilitetit. Gjithashtu, në nenin 46 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të

*stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”* . Gjithashtu, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor cënon stimulimin e pjesëmarrjes së biznesit të vogël/mesëm në procedurat e prokurimit publik. Në një rast hipotetik, një operator ekonomik i cili ka nisur ushtrimin e aktivitetit tregëtar vetëm një vit para pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit publik nuk mund të disavantazohet/skualifikohet për faktin se bilanci financiar ka rezultuar me humbje. Gjithashtu, KPP gjykon se, pasqyrimi i humbjeve në bilanc vijnë për shkaqe të ndryshme si humbja nga ndryshimi i kursit të këmbimit të kërkesave për t’u arkëtuar dhe detyrimeve për t’u paguar (për shembull, huatë e dhëna dhe të marra) në monedhë të huaj e që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese), humbja në kapital, humbja nga shitjet; humbja nga veprimtaritë e shfrytëzimit, shkaqe të cilat jo drejtpërdrejtë lidhen me pa aftësinë pagueuse të pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, KPP gjykon se, *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar si edhe aktet nënligjore në zbatim të tij në asnjë rast nuk parashikon se një operator ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik do të konsiderohet *prima facia* jo i aftë për përmbushjen e kapacitetit ekonomik në drejtim të përmbushjes së kontratës në rast se rezulton se bilanci i një ose më shumë viti është me humbje ( negativ), për sa kohë që ky i fundit nuk është subjekt i ndalimeve të parashikuara nga ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligji nr. nr.8901 datë 23.05.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar.

III.2.6. Sa më sipër, KPP gjykon se, referuar testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e bilanceve pozitive për tre vitet e fundit nuk është në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nuk është e përshtatshme për realizimin e synimit të autoritetit kontraktor dhe shkon për tej asaj çfarë është e nevojshme për të arritur synimin KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin në përputhje me sa më sipër arsyetuar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “*Kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e vertetimit të xhiros per persona fizike, nderkohe qe per personat juridike kerkohen bilancet e tre viteve te fundit, eshte nje kerkese absurde, e cila nuk gjen mbeshtetje ligjore dhe nje percaktim i tille, nuk i ve ofertuesit ne kushte te barabarta konkurimi*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren:

III.3.1.Në shtojcën 8 “*Kriteret e vecanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti ekonomik e financiar*”, pika 3, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar paraqitja e dokumentacionit si vijon:

“*Kopje të 3 (tre) bilanceve në tre vitet e fundit (viti 2013, 2014, 2015 ) të pranuar nga Administrata Tatimore me rezultat pozitiv për personat juridik, ose kopje të deklarimit të xhiros vjetore në Administraten Tatimore për personat fizik.*”

III.3.2. Në nenin 46, pika 1 gëmra “c” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ *[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e*

*mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

*c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;*

III.3.3. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 4, gërma “a” të Vendimit Nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

*“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse ...*

*Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës“*

III.3.4. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

*2. Qëllimi i këtij ligji është:*

*a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*

*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e vërtetimit të xhiros për persona fizike, nderkohe që për personat juridike kerkohen bilancet e tre viteve te fundit, nuk siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, në kushtet kur bëhen diferencime kriteresh sipas kategorisë (biznesit) së ofertuesve, në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së si më sipër cituar.

Për më tepër që, nga ana e autoritetit kontraktor, në informacionin dhe dokumentacionin e depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, nuk jepet asnjë argument mbi të cilët të jetë bazuar vendosja e kërkesës së mësipërme, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014, neni 61, sipas të cilit *dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. [...]*Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Njësia e prokurimit pranë autoriteti kontraktor, e cila në mbështetje të nenit 57 (“Njësia e prokurimeve”), pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është struktura përgjegjëse për “...përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme”, duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, gjithmonë duke e argumentuar dhe dokumentuar kriterin e vendosur prej saj.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit: “*Ne kundërshtim te plote me legjislacionin e prokurimit publik, keni kerkuar qe vertetimi i leshuar nga OSHEE, duhet te jete leshuar jo me pare se 10 dite nga hapja e ofertave, kerkese kjo e cila nuk gjen mbeshtetje ligjore, si dhe bie ne kundërshtim te plote me dokumentat standarde te tenderit. Kjo per faktin se, autoriteti juaj kontraktor nuk mund te detyroje operatorin ekonomik se kur duhet te shlyeje detyrimet e energjise per te marre vertetimin perkates. Pra e rendesishme per ju eshte qe shoqeria te mos kete detyrime te energjise elektrike, si dhe nuk ka asnje rendesi se cfare date mban ky vertetim*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në datën 15.02.2017, autoriteti kontraktor ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit dhe ka publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve shtojcën me ndryshimet e dokumentantave të tenderit si vijon:

*Ishte*

*Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4*

*-Një vërtetim nga furnizuesi i energjisë elektrike, që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, lëshuar jo më parë se 10 ditë nga data e hapjes së ofertave.*

*Bëhet*

*Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4*

*Një vërtetim nga furnizuesi i energjisë elektrike, që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor, ndaj dhe ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit: “[...] janë kërkuar shërbime të së njëjtes natyre, nderkohe që legjislacioni i prokurimit publik, parashikon për shërbime të ngjashme. Kërkesa juaj që duhet të jete të së njëjtes natyre sjell për pasoje kualifikimin e shoqërive që kanë vetëm shërbime të njëjta pra identike me objektin tuaj, nderkohe që ligji e ndalon një kërkesë të tillë, pasi ka të parashikuar shumë qarte, për shërbime të ngjashme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në datën 15.02.2017, autoriteti kontraktor ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit dhe ka publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve shtojcën me ndryshimet e dokumentantave të tenderit si vijon:

*Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3 kapaciteti teknik ,pika 1, gërma a) gërma b)*

*Ishte*

*- Furnizime të mëparshme të së njëjtës natyrë në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se 8,621,561.03 lekë), furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2014, 2015, 2016) të aktivitetit të operatorit ekonomik.*

*Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

*a. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është e realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate .*

*ose*

*b. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturën/at përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.*

*Bëhet*

*Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3 kapaciteti teknik pika 1, gërma a) gërma b)*

*Furnizime të mëparshme të ngjashme në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se 8,621,561.03 lekë), furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2014, 2015, 2016) të aktivitetit të operatorit ekonomik.*

*Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

*a. Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me institucionet shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur vërtetimet e lëshuara nga institucionet shtetërore dhe faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*ose*

- b. Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vertetojë këtë duke paraqitur faturën/at përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor, ndaj dhe ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.6. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *“kerkesa qe sherbimet (identike, pra te njejta,) duhet te jene realizuar ne vitet 2014, 2015 dhe 2016 bie ne kundershtrim me legjislacionin e prokurimit publik, i cili parashikon tekstualisht per tre vitet e fundit”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.2. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, neni 28 *“Kontratat e mallrave”*, pika 2 dhe 3, përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit.*

*Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”*

III.6.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

*Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.6.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet e duhura në lidhje me eksperiencat e mëparshme, në përputhje dhe në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi.

III.6.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor duhet të respektojë përcaktimin e bërë në rregullat e prokurimit publik lidhur me periudhën në të cilën kërkohën përvojat e mëparshme, duke lejuar pjesëmarrjen në tender edhe të shoqërive të cilat dëshmojnë realizimin me sukses të kontratave në periudhën 3 vjecare përpara hapjes së ofertave.

Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kërkesës së mësipërme duke e përcaktuar atë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *ne kundërshtim të plote me LPP, njesia e prokurimit ka kërkuar që, kur kontrata është realizuar me institucione shtetërore, të paraqitet kontrata, shoqëruar me vërtetimin përkatës. Nderkohe, LPP për këtë rast, parashikon paraqitjen në tender të vërtetimit të lëshuar nga një ent publike dhe/ose faturën tatimore të shitjes*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3 kapaciteti teknik”, rezulton se është kërkuar:

*Furnizime të mëparshme të ngjashme në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se 8,621,561.03 lekë), furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2014, 2015, 2016) të aktivitetit të operatorit ekonomik.*

*Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

*c. Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me institucionet shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur vërtetimet e lëshuara nga institucionet shtetërore dhe faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*ose*

*d. Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturën/at përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.*

III.7.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në

*përpjesim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*  
b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.7.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e mallrave”, pika 2 dhe 3, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

*“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit.*

*Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”*

Gjithashtu, në dokumentat standarde të tenderit, të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik e të publikuara në faqen zyrtare të saj, në shtojcën 7, tek seksioni Kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar që autoriteti kontraktues duhet të plotësojë kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe atë teknik.

III.7.4. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për përvojën e mëparshme dhe në këtë kuadër, kontrata është një dokument që dëshmon më së miri përvojën e mëparshme të realizuar nga një operator ekonomik, pasi është një dokument që sigurohet nga të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar dhe që përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për të vërtetuar punët e mëparshme të realizuara si data e lidhjes së kontratës, vlera e realizuar, objekti i kryer, palët kontraktuese etj.

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e ankimesit se: *Ne kriteret specifike per kualifikim, keni kerkuar qe shoqeria duhet te kete te punesuar 20 punonjes kur objekti i prokurimit, mund te realizohet edhe me vetem 10 punonjes dhe brenda nje afati 12 dite pune,* Komisioni



i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që ofertuesit të plotësojnë kushtin si vijon:

*“Të ketë të punësuar jo më pak se 20 (njetete) punonjës. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti juaj i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, për jo më pak se 20 (njetete) punonjës për 3 vitet e fundit 2014, 2015, 2016, dhe të shoqëruar me listpagesat nga sigurimet shoqërore.*

***Për arsye të afatit të limituar për realizimin e : Prodhimit të formularëve dhe kartave të shëndetit, operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve, duhet të sigurojë numrin e nevojshëm të punonjësve në dispozicion, në mënyrë që të sigurohet në kohë realizimi i proceseve për produktin në cilësinë dhe kujdesin e duhur, si: skicimi grafik, dizenjimi, përgatitja, plastifikimi parcial i kartës, paketimi i materialeve si dhe transporti (përfshirë ngarkim/shkarkimin) për në institucion i materialeve, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuar në kontratë.”***

III.8.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar kërkesat mbi prodhimin e formularëve dhe kartave të shëndetit si vijon:

***Sasia :*** 1,198,771 ***copë formular/kartë shëndeti***

***Letër:*** 90 gsm Laserbond

***Ngjyra formulari:*** 4 nga të dyja anët

***Ngjyra karta:*** 4 nga njëra anë

***Formati i formularit:*** A4

***Formati i Kartës:*** i hapur – 5.5cm x 17cm , i mbyllur 5.5cm x 8.5cm

***Numër serial :*** duhet të ketë një numër serial unik të paraprintuar për çdo formular.

***Punime:*** Karta duhet të jetë e inkorporuar tek formulari si pjesë perberese e saj, si edhe të ketë plastifikim parcial. Karta duhet të jetë me prerje gjysëm presioni që të mund tëhiqet lehtësisht nga formulari, të paloset dhe ngjitet.

*Karta duhet të jetë e plastifikuar nga njëri krah, me plastifikim të veçantë i cili mund të printohet dhe personalizohet në pajisjet printuese të Fondit. Gjithashtu plastifikimi special duhet të bëjë të mundur që printimi i personalizimit të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve dhe lagës me ujë.*

***Përmbajtja e formularit dhe kartës së shëndetit:***

*Formulari duhet të përmbajë në një rën anë të fletës logon e Fondit, fushat e kërkesës për pajisje me kartë shëndeti sipas formularit “Kërkesë për pajisje me kartë shëndeti”, kartën e inkorporuar të hapur.*

***1-Përmbajtja e fletës së parme të formularit do të vihet në dispozicion fituesit me paraqitjen e këtij te fundit pranë zyrave të FSDKSH.***

***2- Përmbajtja e fletës së pasme të formularit:***

Në anën e pasme të fletës formulari duhet të përmbajë tekstin informues sipas seksionit “Përmbajtja e fletës së pasme të formularit”

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 307, Datë 21.05.2014, për “Regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, identifikimi i personave të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, bëhet me anë të kartës së shëndetit. Karta e shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguruar. Karta është personale dhe e patjetërsueshme dhe shpërndahet pa asnjë pagesë apo tarifë shërbimi.

Të gjithë personat e siguruar kanë të drejtë të kërkojnë pajisjen me kartë shëndeti:

a. Online nëpërmjet portalit e-Albania, nëse bëjnë pjesë në kategoritë e parashikuara në Tabelën Nr. 1, bashkëngjitur.

b. Duke u paraqitur pranë pikave të shpërndarjes së kartës së shëndetit me dokumentat e mëposhtme:

**Dokumentacioni identifikues** i cili duhet të jetë një nga dokumentet e mëposhtme:

Karta e identitetit;

Çertifikata personale për fëmijët deri në moshën 16 vjeç;

Pasaporta.

• **Dokumentacioni që vërteton kategorinë përfituese.** Dokumentat e kërkuar janë në varësi të kategorisë që i përket i siguruari sipas përshkrimit në Tabelat Nr. 1 dhe Nr. 2. Pas këtij informacioni vendoset tabelat e kategorive përfituese bashkëngjitur.

**Tabela Nr. 1**

<b>Kategoria e personit të siguruar</b>	<b>Teksti në kartë/kategoria</b>	<b>Dokumenti vërtetues</b>	<b>Afati i Vlefshmërisë</b>
<i>I punësuar</i>	<i>I punësuar</i>	<i>NID</i>	<i>1 vit nga data e lëshimit</i>
<i>I vetëpunësuar</i>	<i>I vetëpunësuar</i>	<i>NID</i>	<i>3-muaj nga data e lëshimit</i>
<i>I vetëpunësuar në bujqësi</i>	<i>I vetëpunësuar në bujqësi</i>	<i>NID</i>	<i>Sipas afatit nga sistemi online ISSH</i>
<i>Fëmijë 0-12 muaj</i>	<i>0-12 muaj</i>	<i>NID</i>	<i>Nga data e lëshimit deri në moshën 12 muaj</i>
<i>Fëmijë 1-18 vjeç</i>	<i>1-18 vjeç</i>	<i>NID</i>	<i>Nga data e lëshimit deri në moshën 18 vjeç</i>
<i>Invalid i plotë</i>	<i>Invalid i plotë</i>	<i>NID</i>	<i>Sipas afatit nga sistemi online ISSH</i>
<i>Invalid i pjesshëm</i>	<i>Invalid i pjesshëm</i>	<i>NID</i>	<i>Sipas afatit nga sistemi online ISSH</i>

<i>Invalid luftë</i>	<i>Invalid luftë</i>	<i>NID</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Veteran luftë</i>	<i>Veteran</i>	<i>NID</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Pensionist pa afat</i>	<i>Pensionist pa afat</i>	<i>NID</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Pensionist me afat</i>	<i>Pensionist me afat</i>	<i>NID</i>	<i>1 Vit nga data e lëshimit</i>
<i>Anëtar i Papaguar i Familjes</i>	<i>Anëtar i Papaguar i Familjes</i>	<i>NID</i>	<i>3 Muaj nga data e lëshimit</i>
<i>Përfitues të tjerë nga ISSH</i>	<i>Përfitues nga ISSH</i>	<i>NID</i>	<i>Sipas afatit nga sistemi online ISSH/1 vit</i>
<i>Pension Social</i>	<i>Pension Social</i>	<i>NID</i>	<i>Sipas afatit nga sistemi online ISSH/1 vit</i>
<i>Përfituese e lejes së lindjes</i>	<i>Leje lindje</i>	<i>NID</i>	<i>Sipas afatit nga sistemi online DPT/Sipas shënimit të punëdhënësit në librezën e kontributeve</i>

**Tabela Nr. 2**

<b><i>Kategoria e personit të siguruar</i></b>	<b><i>Teksti në kartë/kategoria</i></b>	<b><i>Dokumenti vërtetues</i></b>	<b><i>Afati i Vlefshmërisë</i></b>
<i>Sigurim vullnetar</i>	<i>Sigurim vullnetar</i>	<i>Kontrata me FSDKSH. Dokumenti që vërteton derdhjen e kontributit vullnetar pranë Drejtorisë Rajonale/Degës</i>	<i>Sipas kontratës me FSDKSH</i>
<i>Student 18-25 vjeç</i>	<i>Student 18-25 vjeç</i>	<i>Karta e identitetit. Vërtetim nga universiteti përkatës, brenda ose jashtë vendit (i përkthyer dhe noterizuar për universitetet jashtë vendit)</i>	<i>1-vjeçar nga data e lëshimit deri në moshën 25 vjeç</i>
<i>Invalid para/tetraplegjik</i>	<i>Para/Tetraplegjik</i>	<i>Vërtetim invaliditeti nga KMCAP/Libreza invaliditeti nga ISSH</i>	<i>Nga data e lëshimit të kartës deri në afatin e vërtetimit</i>
<i>I verbër</i>	<i>I verbër</i>	<i>Libreza përkatëse e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror ose vendim i Komisionit të Verbërisë</i>	<i>Me afat sipas librezës/vendimit të komisionit</i>
<i>Jetim</i>	<i>Jetim</i>	<i>Libreza përkatëse e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror</i>	<i>Sipas afatit të librezës, por jo përtej moshës 25 vjeçare</i>
<i>Grua shtatzënë</i>	<i>Shtatzënë</i>	<i>Vërtetim i/e konsultorit mjeku/fëmija për periudhën e shtatzanisë</i>	<i>Me afat sipas vërtetimit</i>

<i>Person me aftësi të kufizuar</i>	<i>PAK</i>	<i>Vendimi i KMCAP</i>	<i>Me afat sipas vendimit</i>
<i>Person që trajtohet me ndihmë ekonomike</i>	<i>Ndihmë ekonomike</i>	<i>Vërtetim nga njësi e pushtetit vendor për personat e familjes që përfiton ndihmën ekonomike. Për qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan NID</i>	<i>3-mujor nga data e lëshimit të kartës së shëndetit</i>
<i>I papunë punëkërkues</i>	<i>I papunë punëkërkues</i>	<i>Kartela personale e punëkërkuesit të papunë, lëshuar nga zyra rajonale e shërbimit kombëtar të punësimit</i>	<i>3-mujor nga data e lëshimit të kartës së shëndetit</i>
<i>Azilkërkues</i>	<i>Azilkërkues</i>	<i>Leje-qëndrimi për të huajt nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin</i>	<i>Nga data e lëshimit deri në afatin e qëndrimit sipas përcaktimit në lejen e qëndrimit</i>
<i>Viktima të trafikimit</i>	<i>VT</i>	<i>Sipas listës emërore të lëshuar nga Njësia Antitrafik e Ministrisë së Punëve</i>	<i>Një vjeçar nga data e lëshimit të vërtetimit</i>
<i>Persona me Sëmundje Kronike sipas përcaktimeve të Ministrisë së Shëndetësisë</i>	<i>Sëmundje Kronike</i>	<i>Përgjigja e konsultës së specializuar që vërteton diagnozën kronike</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë</i>	<i>PP</i>	<i>Vërtetim për dhënie statusi i lëshuar nga Instituti i Integritetit Ish-të Përndjekurve Politikë, përkatësisht për grupin A1 ose B</i>	<i>Pa afat</i>
<i>Person në IEVP</i>	<i>IEVP</i>	<i>Sipas dokumentit të lëshuar nga Drejtoria e IEVP</i>	<i>Sipas periudhës së përcaktuar në dokument</i>

Në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të dokumentave të tenderit, është kërkuar:

*Sasia e mallit që kërkohet:*

<i>NR</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Prodhimi i formularëve dhe kartave të shëndetit</i>	<i>copë</i>	<i>1,198,771</i>

### **LËVRIMI I MALLIT:**

**Afati i lëvrimit për skicimin grafik:** 24 orë nga momenti i dhënies së informacionit që do të perfshihet në të.

Fondi ka të drejtë të korrigjojë përmbajtjen e formularit deri në momentin e pranimit të skicës grafike të formularit.

### **Testimi i formularit dhe kartës së shëndetit përfundimtar:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë 20 copë modele të ngjashme, por me karakteristika teknike identike, të cilat do ti nënshtrohet testimit nëse respektojnë kushtet e mësipërme

teknike dhe janë të personalizueshëm nga printerat e institucionit. Pas konfirmimit nga komisioni i ngritur për këtë qëllim nga Fondi, do të prodhohet e gjithë sasia e kërkuar.

**Afati i lëvrim:** **20 ditë nga dita e lidhjes së kontrates.**

Me realizimin me sukses të testimit, operatori duhet të bëjë lëvrimin e sasisë së kontraktuar të formularit dhe kartës së shëndetit.

Formularët do të lëvrohen të pakeluar në sasi 1000-2000 fletë për kuti.

- Mallrat do të dorëzohen në magazinën e Fondit dhe do të merren në dorëzim nga një komision i ngritur për këtë qëllim.
- Transporti i mallrave (përfshirë ngarkim/shkarkimin) do të realizohet me mjetet e kontraktuesit.

III.8.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

- a) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktues në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.8.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.8.5. Sipas ankimesit objekti i prokurimit, mund të realizohet edhe me vetem 10 punonjes pasi, sipas tij, “procesi i shtypit kërkon 1 makinist dhe 1 ndihmes makinist dhe realizohet në 4 dite pune, procesi i plastifikimit fillon ditën e dytë të punës dhe kërkon si afat maksimal prej 3 dite të tilla pune dhe 1 punonjes; procesi i numratorit automatik kërkon po 3 dite pune dhe 1 punonjes; procesi i prerjes kërkon vetem 2 dite pune dhe 1 punonjes. Gjithashtu do duhen edhe punonjesit si vijon për realizimin e këtij procesi: 1 financier, 1 magazinier, 1 projekt menaxher dhe 1 dizajnues (grafik designer).”

III.8.6. Me shkresën nr. 873/2 prot., datë 24.02.2017 autoriteti kontraktor sqaron se, “sipas kërkesave të vecanta të kualifikimit ka edhe zëra të tjera të punës që kërkojnë fuqi punëtore, përvec atyre të përmenduar nga ankimuesi.. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka marrë edhe përvojën e autoriteteve të tjera që kanë bërë prokurime të ngjashme dhe në të gjitha rastet ky numër punonjësish është parë i arsyeshëm të vendoset si kërkesë kualifikimi”.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se procesi i prodhimit të formularëve dhe kartave të shëndetit është parashikuar të realizohet për një periudhë 20 ditore nga ana e autoritetit kontraktor dhe në të përfshihen procese si *skicimi grafik, dizenjimi, përgatitja, plastifikimi parcial i kartës, paketimi i materialeve si dhe transporti (përfshirë ngarkim/shkarkimin)* për në institucion i materialeve.

Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kontekst si dhe referuar dokumentave të tenderit dhe konkretisht *Shtojcës 10 “Specifikimet teknike”*, në të cilën është dhënë përshkrimi i produkteve të kërkuara, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për 20 punonjës është parashikuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe periudhën e shkurtër të dorëzimit të formularëve dhe kartave të shëndetit në kushtet kur sasia e produktit të kërkuar është tepër e lartë dhe afati i lëvrimit i përcaktuar nga autoriteti kontraktor është i shkurtër, me vetëm 20 ditë.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës. Referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet dhe afatit të dorëzimit të formularëve dhe kartave të shëndetit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, është përcaktuar në përpjestim me natyrën dhe vëllimin e kontratës që do të prokurohet.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.8.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: [...] *Kërkesa për numrin e punonjësve edhe për vitin 2014 është diskriminuese, në kundërshtim me ligjin, si dhe ul konkurrencen në prokurim. Kjo për faktin se, numri i punonjësve për muajin janar 2014 është jashtë tre viteve të fundit. Pra, e rëndësishme për institucionin tuaj është që operatori ekonomik të disponojë numrin e punonjësve, për të pakten tre muajt e fundit, si dhe nuk ka asnjë rëndësi për ju nëse i ka patur apo jo këte numer edhe për vitet 2014 dhe 2015. Një kërkesë*

*e tille, sjell si pasoje uljen e konkurrences ne prokurirn, si dhe diskriminimin e kandidateve [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.8.7.1. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

*2. Qëllimi i këtij ligji është:*

*a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*

*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.8.7.2. Referuar pikës III.8.1. të arsytimit, përsa i përket pretendimit të ankimuesit për periudhën e kërkuar për numrin e punonjësve, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kjo kërkesë e autoritetit kontraktor është e ekzagjeruar, që i tejkalon përmasat e kontratës që prokurohet dhe nuk i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë lidhur me personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.8.8. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “*njesia e prokurimit nuk ka percaktuar sakte lidhur me numrin e punonjesve, ku duhet te parashikojë numrin mesatar te tyre*”, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, përcaktuar si në pikën III.8.1. të arsytimit, Komisioni Prokurimit Publik gjykon se kërkesa për numrin e punonjësve (prej 20 punonjës), për periudhën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, ka si synim kryesor paraqitjen e një panorame të qartë kundrejt autoritetit kontraktor lidhur me fuqinë punëtore të operatorit ekonomik pjesëmarrës, si edhe kapaciteteve të tij për lëvrimin me sukses të kontratës. Kërkesa e autoritetit kontraktor nuk duhet të jetë e lidhur *strictu sensu* me numrin e punonjësve për secilin muaj, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë, të punësuar për secilën periudhë të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi në një rast hipotetik një operator ekonomik do të s’kualifikohej për mos plotësim të numrit të punonjësve vetëm se në një periudhë të caktuar (një muaj) nuk ka të punësuar një ose më shumë punonjës sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, kur ky i fundit vërteton se në vijueshmëri dhe në total si mesatare e fuqisë punëtore e plotëson ose e tejkalon numrin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Përsa parashtruar, pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me me Nr. REF-66497-02-02-2017, me objekt: “*Prodhimi i formularëve dhe kartave të shëndetit*”, me fond limit 21.553.902,58 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.02.2017 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k .
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 251 Protokolli,**

**Datë 20.02.2017**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**